

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për organizimin dhe punë në organet e administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 , 51/11 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 50 paragrafit 6 nga Ligji për arsim fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/2019) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore **Shkencat natyrore për klasën VI (gjashtë)** të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

## 1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor për lëndën mësimore **Shkenca natyrore për klasën VI (gjashtë)** të arsimit fillor për vitin shkollor 2020/21 bazohet në qëllimet e parashikuara nga programi mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet në përputhje me planin mësimor.

Me programin e shkurtuar përcaktohen temat e caktuara dhe njësitet mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, gjatë së cilës duhet të merret parasysh fondi javor i orëve të përcaktuara në programin e rregullt, domethënë për një lëndë me 2 orë në javë parashihen 64 orë në programin e shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/ rezultatet e pritura, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

## 2. Pasqyra e temave dhe njësive mësimore

**Tema 1 – Ndryshimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme (8 orë) (6+2)**

**Njësitet mësimore**

1. Njohja me ndryshimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme
2. Ndarja e materieve të ngurta
3. Ndarja e materies së ngurtë nga lëngu
4. Tretjet dhe përzierjet
5. Djegia
6. Gatimi

**Tema 2 – Organet dhe sistemet në trupin e njeriut (11 orë) (8+3)**

### **Njësitë mësimore**

1. Organet e trupit
2. Digjestionit, absorbimi dhe ekskrecioni
3. Sistemi ekskretor
4. Sistemi nervor- truri
5. Respiracioni dhe frymëmarrja
6. Sistemi qarkullues- zemra
7. Sistemi reprodaktiv
8. Bëhuni ekspert

### **Tema 3 – Përçuesit dhe izolatorët (8 orë) (4+4)**

#### **Njësitë mësimore**

1. Përdorimi i përçuesve dhe izolatorëve
2. Ndryshime në qarqet elektrike- fer testim
3. Skemat e qarqeve elektrike 1
4. Skemat e qarqeve elektrike 2

### **Tema 4 – Kujdesi për mjedisin jetësor (11 orë) (7+4)**

#### **Njësitë mësimore**

1. Ndikimi në mjedisin jetësor
2. Efektet pozitive – Parqet nacionale
3. Mbeturinë
4. Efekti i serrës dhe ndryshimet klimatike
5. Zvogëlo, përdor përsëri, riciklo
6. Hedhja e mbeturinave
7. Kursimi i energjisë

#### **Tema 5 – Rritja (4 orë) (3+1)**

##### **Njësitë mësimore**

1. Rritja ime - Puberteti
2. Rritja ime- më parë, tani dhe në të ardhmen
3. Menstruacioni dhe cikli menstrual

#### **Tema 6 – Zinxhiri i të ushqyerit (9 orë) (7+2)**

##### **Njësitë mësimore**

1. Vendbanime lokale
2. Kafshët e egra lokale
3. Zinxhiri i të ushqyerit – konsumatorët
4. Zinxhiri i të ushqyerit – prodhuesit
5. Raportet e ndërsjella në ekosistemet konkrete

6. Adaptimi dhe maskimi
7. Hibernacioni ose migrimi?

## **Tema 7 – Forca dhe Lëvizja (13 orë) ( 7+6)**

### **Njësitë mësimore**

1. Njohja me forcat dhe lëvizjen
2. Forca e gravitacionit dhe paraqitja e forcave
3. Forca dhe energjia
4. Fërkimi
5. Matja e fërkimit
6. Rezistenca e ujit – notimi dhe fundosja
7. Rezistenca e ajrit

### 3. Rekomandimet didaktike

Me programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore Shkenca natyrore për klasën VI (gjashtë) të arsimit fillor, janë përfshirë tema dhe njësi të caktuara mësimore nga programi i rregullt mësimor të cilat janë në korelacioni të ndërsjelltë dhe përbëjnë një tërësi logjike. Në pjesën *Pasqyra e temave dhe njësive mësimore* janë renditur temat dhe njësitë mësimore të përcaktuara me programin e shkurtuar mësimor që i referohen zhvillimit të përmbajtjeve të reja mësimore. Për secilën temë është dhënë numri i përgjithshëm i orëve mësimore që duhet të realizohet. Duke pasur parasysh se është bërë renditja e njësive mësimore që i referohen zhvillimit të përmbajtjeve të reja mësimore, numrin e mberur të orëve mësimore në kuadër të temës përkatëse mësimdhënësi e planifikon, organizon dhe realizon si orë mësimore për përsëritje, përforcim, ushtrime, kontrollim i njohurive të nxënësve, sistematizim, hulumtim etj.

Përzgjedhjen dhe kombinimin e metodave, formave dhe ecurive përkatëse në mësimdhënie, mësimdhënësi i bën drejtëpërdrejt gjatë planifikimit dhe konceptimit të mësimdhënies dhe organizimit të orës mësimore, në përputhje me afinitetet e nxënësve dhe mundësi materiale-teknike të shkollës (kushtet dhe pajisjet).

Gjatë realizimit të mësimdhënies në përputhje me programin e shkurtuar mësimor, duhet patur parasyshë rekomandimet didaktike, respektivisht format, metodat dhe aktivitetet e parapara në programin e rregullt mësimor, të cilat u referohen përmbajtjeve mësimore të përfshira në programin e shkurtuar mësimor. Rekomandohet përdorimi i TIK në çdo segment të procesit mësimor.

### 4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënës në përputhje me normativin për kuadër mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën **Shkenca naryrore për klasën VI (gjashtë)** të arsimit fillor e miratoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska